# FR19

profloor
smart flooring solutions


1.Pastrimi i nënshtresës


2.Identifikimi i çarjeve dhe/ose fugave

Çarjet e holla zgjërohen aq sa rrëshira e lëngët rrjedhëse mund të derdhet më lehtë. Tek çarjet, të cilat shkojnë tej tërë trashësisë së estrihut, duhet në distancë rreth 25 cm me anë të Flexit të bëhen prerje tërthore deri në 2 të tretat e trashësisë së estrihut, kështu që më vonë të mund vendosen lidhëset valore.
Para derdhjes së materialit copëzat dhe pjesët jostabile të estrihut duhet të hiqen si dhe fugat dhe çarjet të thithen me kujdes.


3.Zgjërimi i fugave/çarjeve të holla


4.Pastrimi dhe thithja e puhurit

Rrëshira dhe forcuesi duhet të perzihen në proporcion të drejtë (lexo përshkrimin në paketim dhe informacionet e prodhimit) dhe në sasi të duhur, e cila mundëson përpunimin para fillimit të tharjes. Me këtë përzierje mbushen çarjet e holla. Për mbushjen e çarjeve dhe fugave të gjëra duhet të shtohet sasi e mjaftueshme e rërës kuarci, për t`a ngritur konsistencën.



5.Mbushja e fugave, vendosja e lidhëseve


6.Hedhja e rërës kuarci përsipër

Lidhëset valore shtypen në rrëshirën ende të lëngët dhe përsëri mbulohen me rrëshirë. Pastaj rrëshira e tepërt tërhiqet me shpatull përgjatë çarjeve ose fugave në gjërësi më të ngushta dhe me rërë kuarci mbulohet mjaftueshëm. Në afat orëshe çarjet janë të mbyllura fortë, punimet e shtruarjes së dyshemesë mund të vazhdojnë.

Për më tepër informata:
profloor.ks@gmail.com ose në +383 49 303 769